

VENDIM
Nr. 110, datë 7.9.2015

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “MESOPOTAM ENERGY” SHPK NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “DRIZA”
(ME FUQI TË INSTALUAR 3.408 MW)**

Në mbështetje të neneve 16; 37 pika 2, germa “a” dhe 110 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5 pika 1, germa “a”, 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.9.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Mesopotam Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për Licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Mesopotam Energy” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesëshëm dhe rinovimit të licencave” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Mesopotam Energy” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Driza”, me fuqi të instaluar 3.408 MW, për një afat 30 - vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti